



NA. prot 1470
dt. 1.3.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë
dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i
Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology
and Innovation

PROTOKOLL I PËRBASHKËT

PËR

ADMINISTRIMIN E FONDEVE TË VËNA NË DISPOZICION PËR PROJEKTIN MADHOR NË ALBANOLOGJI “ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE”

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë (në vijim MAS) dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës (në vijim MASHTI); të përfaqësuara nga titullarët përgjegjës të tyre, ministrat znj. Evis Kushi dhe znj. Arbërie Nagavci; përfaqësuese të autorizuara nga qeveritë respektive të dy vendeve për nënshkrimin e këtij Protokollit të Përbashkët;

Në zbatim të nenit 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar në Prishtinë më 20 qershor 2022, dhe ratifikuar me nr. 80/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëfinancimin e projektit madhor në Albanologji “Enciklopedia Shqiptare””;

Nënshkruajnë këtë Protokoll të Përbashkët:

Me anë të të cilit zotimet e dy qeverive në Marrëveshjen sipërcituar për financimin e përgatitjes dhe të botimit të Enciklopedisë shqiptare nga Palët zbatuese (Akademia e Shkencave e Shqipërisë - ASHSH dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës - ASHAK) shprehen në terma administrativë dhe në kushte ekzekutivë; që përfshijnë shumën / shumat që do të akordohen; përpjesëtimet në kontribute; kohëzgjatjen dhe kalendarin e financimit; tarifatat për pagesat për punë drejtuese dhe të drejtë autori; si dhe çështje të tjera teknike, si më poshtë:

1. Financimi i këtij projekti bëhet nga secila *Palë nënshkruese* për pjesën e vet, mbështetur në kërkesat e *Palës zbatuese* përgjegjëse. Kërkesa për buxhet bëhet në baza vjetore nga të dyja palët zbatuese, në bazë të planifikimeve.
2. Ky buxhet jepet për hartimin e zbatimin e *Projektit*, për mbështetje logjistike dhe për shërbime ndihmëse. Për përgatitjen përfundimtare për botim dhe shtypshkrimin buxheti caktohet një vit para afatit të caktuar në *Marrëveshje* për realizimin e *Projektit*. Veprimet financiare që kryhen në kuadër të hartimit dhe zbatimit të *Projektit*, raportohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
3. Palët nënshkruese të *Marrëveshjes* marrin përsipër t'u përgjigjen kërkesave për buxhet të *Palëve zbatuese* për projektin shkencor ndërkademi "Enciklopedia Shqiptare" për një periudhë 5 (pesë) - vjeçare. *Palët zbatuese* argumentojnë çdo vit, brenda muajit tetor, nevojat për buxhet për vitin pasardhës dhe raportojnë për ecurinë e *Projektit* brenda tremujorit të parë dhe sa herë të kërkohet gjatë vitit te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe/ose *Palët nënshkruese*.
4. Fondi i akorduar nga *Palët nënshkruese* për Projektin vihet në dispozicion të *Palëve zbatuese* si zë më vete i buxhetit vjetor, pa prekur masën dhe strukturën e financimit të përvitshëm të tyre sipas projektbuxhetit afatmesëm (PBA për ASHSH) dhe sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH për ASHAK).
5. Financimi i *Projektit* nis nga data 1 janar 2023. Në përfundim të afatit 5 (pesë) vjeçar *Palët zbatuese* dorëzojnë në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Kosovës veprën "Enciklopedia Shqiptare" në formë të përfunduar, si në pikëpamjen shkencore dhe në atë teknike. Një kopje u dorëzohet ministrive përgjegjëse, nënshkruese të *Protokollit të përbashkët*.
6. Drejtuesit e *Projektit* dhe ata të redaksive, anëtarët e redaksive qendrore, vendore e të fushave, që zgjidhen a emërohen nga *Palët zbatuese* në përputhje me Rregulloren e përbashkët, "Për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të *Enciklopedisë Shqiptare*", përfshirë edhe sekretarët e redaksive, shpërblehen:
 - 6.1 Me kohë të pjesshme, sipas përgjegjësisë e kontributit, nga 10 përqind deri në 70 përqind të pagës së profesorit / akademikut, për ASHSH;
 - 6.2 Me kohë të pjesshme, sipas përgjegjësisë dhe kontributit, nga 20 përqind deri në 50 përqind të pagës neto të profesorit të rregullt universitar për ASHAK. Pagesat për shërbime specifike shkencore e redaktuese vendosen prej vetë *Palëve zbatuese*, sipas ngarkesës, përgjegjësisë, hierarkisë e përshkrimit të shërbimit.

7. Shpërblimi i autorëve për hartimin e veprës shkencore (përgatitje artikujsh enciklopedikë si: artikuj përmbledhës, artikull i vogël, artikull i mesëm, artikull i madh e artikull monografik), bëhet:
- Për artikull të vogël - 60.00 € deri në 90.00 €;
 - Për artikull të mesëm - 170.00 € deri në 200.00 €;
 - Për artikull përmbledhës pagesa njësohet me atë të artikullit të mesëm;
 - Për artikull të madh - 400.00 € deri në 420.00 €;
 - Për artikull monografik 30.00 € për faqe të daktilografuar ose 420.00 € për tabak autori. Tarifat e shprehura në euro konvertohen në lekë nga ASHSH, sipas kursit mesatar vjetor. Brenda marzhit të mësipërm vendosin kryesitë përgjegjëse.
8. Shërbimet ndihmëse përballohen kryesisht nga njësitë e ngritura posaçërisht, si dhe nga administrata ndihmëse e *Palëve zbatuese*.
- 8.1 Pagesa për të punësuarit në njësi ndihmëse për ASHSH është e njëjtë me atë të specialistëve me të njëjtin pozicion pune në administratën e saj dhe në institucionet e arsimit të lartë. Puna që kryhet për nevoja të veçanta jashtë orarit nga administrata ndihmëse e ASHSH paguhet deri 30 për qind të pagës së specialistit në pozicionin përkatës.
- 8.2 Shërbimet ndihmëse për ASHAK kryhen nga struktura e veçantë që ngarkohet për kryerjen e punëve, sipas Rregullores së përbashkët “*Për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë Shqiptare*” (neni 12, paragrafët 5, 6 e 7). Për shërbimet e kryera të angazhuarit në strukturën e veçantë të ASHAK marrin pagesë shtesë (nga kategoria paga dhe mëditje), e cila përcaktohet me vendim të veçantë të miratuar nga Kryesia e ASHAK.
9. Specialistët e jashtëm që kontraktohen nga *Palët zbatuese* paguhën sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e shërbimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
10. Protokollin i përbashkët hartohet në katër kopje, dy për *Palët nënshkruese* e dy për *Palët zbatuese*. Protokollin hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga *Palët nënshkruese*.

Për:

**Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të
Republikës së Shqipërisë**

**Ministrinë e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Informacionit të
Republikës së Kosovës**

Evis KUSHI



Arbërie NAGAVCI